

Ndikimi i Stinëve tek Infeksjonet me Parazit tek Fëmijët

Majla Salihu¹, Kujtesa Hoti²

ABSTRAKTI

Hyrje: Parazitët janë organizma që jetojnë jashtë organizmave të tjerë, ose ushtrive, për të mbijetuar. Disa parazit nuk ndikojnë ndjeshëm në ushtarët e tyre, të tjerët rriten, riprodhojnë ose pushtojnë sistemet e organeve, duke rezultuar në një infeksion me parazit.

Qëllimi i hulumtimit “Ndikimi i stinëve nëshfaqjen e infeksioneve me parazit tek fëmijët” është të zbulojë ndikimin e faktoreve klimatik, ndryshimin e motit, te stinëve dhe ndikimin e shumë faktorëve të tjerë në shfaqjen e infeksioneve parazitare më të shpeshta tek femijet, dhe simptomat e këtyre infeksioneve. Me anë të këtij hulumtimi shihet qartë se femijët janë të prekur nga infeksionet me parazit.

Metodologjia: Qasja ishte restrospektive, grumbullimi i të dhënave është bërë me anë të marrjes së të dhënave nga protokolet nga qyteti i Gjilanit, “Instituti I Shëndetit Publik në Gjilan”, Tre Laboratore Mjekore private në Gjilan, “Instituti I Shëndetit Publik” në Prishtinë, Tre Laboratore Mjekore private në Prishtinë, Spitali American në Prishtinë dhe qytetin e Ferizajit ‘Spitali Përgjithshëm i Ferizajit’ Klinika Pediatrike. Nga ky hulumtim kemi mbledhur gjithsej 400 mostra, prej tyre 220 femra dhe 180 meshkuj.

Rezultatet: Rezultatet tregojnë se infeksionet me parazit janë të shpeshta tek gjinia femrore, si dhe sezoni me mostra më të shpeshta është Pranvera. Parazitet që ishin të shprehur me shumti tek femijet ishin *Gardia lamblia*, *Entamoeba histolytica*, *Entamoeba coli*. Nga atë gjitha mostrat e mbledhura *G.lambli*a ishte me frekuencë më të larët. Nga tabelat e kryqëzuara $p\text{-valu}= 0.390$, nuk ishte signifikante, që do thotë nuk kishte korelacion në mes të parazitit të pranishëm dhe sezonit. $p\text{-valu}= 0.000$, është signifikant, që do thotë kishte korelacion në mes të parazitit të pranishëm dhe qytetit. $p\text{ value}= 0.000$, është signifikant, kishte korelacion në mes të parazitit të pranishëm dhe shfaqjes së simptomave.

Rekomandimet: Rekomandimet e dalura nga ky hulumtim, tregojnë se higjena personale, mjedisore si dhe qasja e ujit të pijshëm janë faktorët kyqë në mbrojtjen nga infeksionet me parazit.

Fjalët kyqe: infeksionet, parazitët, *Entamoeba coli*, *Entamoeba histolytica*, *Gardia lamblia*